



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
SEKTORI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE, LETRAVE DHE PLATFORMËS
SË BASHKËQEVERISJES**

Nr. 3432/ 1 prot.

Tiranë, më 09.04.2025

Lënda: Kthim përgjigje

GJYKATËS SË APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

TIRANË

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me nr. 3432 prot, datë 26.03.2025, në të cilën kërkon informacion lidhur me përcaktimin e moshës për pension pleqërie për dy punonjësit e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, znj. M. P. dhe z. E. D., ju informojmë se:

Bazuar në nenin 31, të Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: *personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92 të po këtij ligji.*

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me ligjin nr. 104, datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703/ 11.05.1993”, nga data 01.01.2015 vjetërsia e plotë e kërkuar për pension pleqërie si për gratë edhe për burrat shtohet në mënyrë graduale me nga 4 muaj çdo vit deri në vitin 2032.

Znj. M. P., është e datëlindjes 1963 dhe sipas nenit 92, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, e drejta për të përfutur pension pleqërie i lind në datën 11.06.2025, në moshën 61 vjeç e 10 muaj dhe me vjetërsi të plotë 38 vite e 8 muaj.

Ndërsa, z. E. D.M., i datëlindjes 1960 dhe sipas nenit 92, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, e drejta për të përfutur pension pleqërie i ka lindur në vitin 2025, në moshën 65 vjeç dhe me vjetërsi të plotë 38 vite e 8 muaj.

Nëse plotësojnë kushtet e kërkuara në ligj, në momentin e plotësimit të moshës për pension duhet të aplikojnë me kërkesën për caktim pensioni pleqërie. Aplikimi bëhet on-line në portalin e-Albania, tek shërbimi "Aplikim për pension pleqërie, suplementar pilot, suplementar lundruar i nëndetëseve apo suplementar për akademik" në zbatim të neneve 31, 32, 92, 95, të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993. Në këtë aplikim duhet të deklarojnë saktë të gjitha periudhat e punësimit sipas ndërmarrjeve/subjekteve ku kanë punuar.

Menjëherë pas aplikimit, dokumentet origjinale të pensionit së bashku me kopjen e aplikimit, duhet të dërgohen nëpërmjet shërbimit postar në adresë të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ku kanë vendbanimin.

Strukturat Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, do të kryejnë verifikimet përkatëse, do të vlerësojnë dokumentacionin dhe do të informojnë aplikuesit në lidhje me caktimin e pensionit brenda afateve zyrtare konform legjislacionit në fuqi.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

Konceptoi: A. Shimaj

Miratoi: Xh. Koxhaj